


**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**  
**Për Programin e studimit “BSc Arsim Parashkollor dhe Fillor”**

**Ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër” {KUB}**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**  
**Prof.Dr.Gezim Dibra**  
**Prof.As.Dr.Mariana Sinani**



Shkurt, 2019, Tiranë

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc “Arsim parashkollor dhe Fillor”**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Bedër”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Filologjisë dhe Edukimit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licensuar me nr 330, datë 07.08.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Akredituar me UMASH nr 223, datë 04.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	BSc. “Arsim Parashkollor dhe Fillor”
6	Cikli i studimit:	Cikli I parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
16	Numri i studentëve	36 studentë

**Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

## HYRJE

Vizitat e planifikuara në Insitucionin KUB, Kolegji Universitar Bedër, në datat 5 dhe 6 shkurt 2019, u realizuan nga GVJ, përbërë nga Prof. Dr. Gëzim Dibra, Prof.As.Dr. Mariana Sinani, asistuar nga specialistë të ASCAL, Znj. Suela Kromidha dhe Znj Avjola Bardhi, përmbushën objektivat e vizitës konform procedurave të miratuara për akreditim, dhe agjendës së përcaktuar nga dy institucionet respektive. Vizitat e zhvilluara në mjediset e KUB, takimet e punës sipas planifikimit të paracaktuar nga stafi i Zyrës ASCAL, na ndihmuan të saktësojmë shumë nga proceset në funksion të përmbushjes së programit në fjalë. Vizita u përmbush konform një protokollit të përcaktuar dhe miratuar nga dy institucionet respektive.

Qëllimet e GVJ, u bënë të hapura në praninë e strukturave të Institucionit. Përgjatë vizitës, gjetëm mirëkuptim në funksion të së mirës së përbashkët që e synojnë të dy institucionet respektive dhe që është "cilësia" dhe "standardi" në proces dhe në përmblydhje të programit.

Konstatojmë që: stafi akademik edhe personeli, përfshirë të gjitha nivelet dhe strukturat që nga institucioni i dekanit, përgjegjësit të departamentit, përgjegjësit të zyrës së personelit dhe të kurrikulave, përfaqësues të studentëve, punonjësja e bibliotekës, përcollën përgjegjëshmëri institucionale dhe sjellje etike. I njëjti seriozitet, përgjegjëshmëri dhe komunikim u përcoll edhe nga i gjithë ekipi i Vlerësimit të Jashtëm.

### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në "Arsim parashkollor dhe Fillor"

Kolegji Universitar "Bedër" (KUB) u çel me vendimin nr. 286, date 06.04.2011 të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit u miratua dhënia e licensës për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë. KUB, si institucion në fushën e arsimit të lartë funksionon si organizatë jofitimprurëse. Akreditimi i parë institucional është bërë në vitin 2013 nga ish-APAAL sot, ASCAL, dhe rikonfirmimi i këtij vlersimi është bërë nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL në vitin 2017

Programi i studimit Bachelor në Arsim Parashkollor dhe Fillor, është hapur/licensuar me Vendimin nr 351 të Këshillit të Akreditimit datë 13.07.2012, dhe Urdhër të MAS nr 330 datë 07.08.2012. Në këtë Urdhër, emërtimi i programit është "Bachelor në "Arsimin parashkollor dhe fillor".

Programi i studimit i nënshtrohet akreditimit të tij, 1 (vit) pasi është licensuar. Konkretisht është vlerësuar me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr 469, datë 03.05.2013 dhe mbështetur në këtë VKA është akredituar me rekomandime me Urdhër të MASH Nr 223, datë 04.06.2013 me emërtimin Bachelor në "Arsim parashkollor dhe fillor". Me Urdhër të MAS Nr 61, dt 09.02.2016 "Për rregjistrimin e formave të diplomave ...." Emërtimi i këtij programi është Bachelor në "Arsimin parashkollor dhe fillor". Me Urdhër Nr 420, dt 20.09.2017 "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr 61, datë 09.02.2019, emërtimi i këtij programi është Bachelor në "Arsim parashkollor dhe fillor".

Përsa më sipër, GVJ ishte para faktit se cili është emërtimi i saktë i këtij programi pasi herë paraqitet si Bsc në "Arsim parashkollor dhe fillor" dhe herë si Bsc në "Arsimin parashkollor dhe fillor". Vlen të theksohet se Raporti i vlerësimit të Brendshëm është i gjithi me emërtimin Bsc në "Arsimin parashkollor dhe fillor". Përgjegjësi i Departamentit dhe Koordinatori Institucional, në takim përmblyllës, na sqaruan se emërtimi i përdorur në RVB është lapsus nga Grupi vlerësimit të Brendshëm. Emërtimi i këtij programi, i cili është i rregjistruar edhe në Rregjistrin e formave të diplomave është **Bachelor në "Arsim parashkollor dhe fillor"**. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit pjesë e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit, licensuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011, "Për licencimin e institucionit Privat të Arsimit të Lartë "Shkolla e Lartë "Hëna e plotë" (Bedër).

Departamenti i Shkencave të Edukimit vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore. Departamenti, fokusohet në fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave të edukimit, psikologjisë së këshillimit dhe pedagogjisë. Programi Bachelor në Arsim Parashkollor dhe Fillor mundëson arsim dhe edukim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar të ndërtojnë karrieren e tyre profesionale në mësuesi në ciklin parashkollor dhe fillor, dhe priren të thellojnë më tej karrierën si kontribues në fushat e edukimit.

Më datë 20.02.2019 është dërguar nëpërmjet sistemit por edhe zyrtarisht Draft RVJ në Institucion. Më datë 25.02.2019 vjen përgjigja/komente nga Institucioni nëpërmjet sistemit mbi këtë Draft. GVJ i pa me vëmendje këto komente dhe merr në konsideratë dy prej tyre duke bërë edhe ndryshimet përkatëse në Raportin përfundimtar.

Përgjigja e GVJ në lidhje me komentet e KUB për Draft RVJ është në fund të Raportit.

Programi i studimit Bachelor në Arsim Parashkollor dhe Fillor është Akredituar me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr 469 datë 03.05.2013. Në këtë Vendim, me të cilën është mbështetur edhe Urdhëri nga MASH për akreditimin e programit, janë lënë rekomandimet e mëposhtëme:

#### **Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

- a) Të rishikohet/riformulohet më mirë nga ana gjuhësore/kuptimore emërtimi aktual i diplomës.
- b) Të përmirësohen objektivat për formimin e studentëve në këtë program, pasi janë përshkruar në mënyrë të përgjithshme, në disa raste të formuluar jo korrekt nga ana gjuhësore dhe pa cilësuar tipin/kategorinë e kompetencave profesionale (të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme) që pritet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që profilizojnë qartazi programin në specialitetin e mësuesisë/edukatorit të arsimit parashkollor dhe fillor.
- c) Të rishikohet raporti teori – praktikë në mbështetje të Udhëzimit Nr.30 i MASH-së, datë 29.07.2008 “Për organizimin e studimeve të larta universitare për formimin universitar të mësuesve”, fq. 29-30, “Plani mësimor i programit të studimit në mësuesi për arsimin fillor”, parashikon për praktikën shkollore 425 orë në total.
- d) Të parashikohen në planin mësimor forma të tjera të mësimdhënies si veprimtari praktike / laboratorike / vrojtuese të specifikuar sipas fushës / tematikës, për ato disiplina të cilat kanë (P.sh Edukimi figurativ; Shkencat e natyrës, Metodologjitë/didaktikat e ndryshme, informatika, etj.
- e) Të rritet numri i stafit të kualifikuar me gradën Dr

#### **Përsa i përket plotësisimit të rekomandimeve, GVJ konstaton se:**

1. Për rekomandimin e parë - Institucioni ka bërë përpjekje për të përmirësuar formulimin e diplomës dhe suplementit. *Nuk mendojmë se i ka dhënë zgjidhje përfundimtare këtij problemi.* Ka ndryshime në emërtim në vendimet e MASR- së në kohën e licensimit dhe të akreditimit të këtij programi.
2. Për rekomandimin e dytë - Institucioni *ka përmisuar objektivat e programit nga të përgjithshmet e specifike, të transferueshme.* Por, nuk ka përkthyer objektivat në kopetenca profesionale. Institucioni ka dorëzuar pranë MASR programet e reja të studimit të ndara në: BSc “Arsim parashkollor dhe Fillor”, si dhe program Master profesional në “Arsim Fillor” por ende nuk është zbatuar një ndarje e tillë.
3. Për rekomandimin e tretë - Institucioni *ka shtuar numrin e orëve të praktikës profesionale duke e fuqizuar atë përmes formave të intershipit në institucione gjatë periudhës së verës. Kurse raportet dije teorike - dije aplikative në lëndë specifike nuk gjenden ende të formuluar në syllabuset.*
4. Për rekomandimin e katërt - *Institucioni ende arsyeton se mësimdhënja dhe metodat specifike që lidhen me lëndë specifike, është konceptuar si një gërshëtim i leksionit me ushtrime, laboratore, veprimtari praktike e punë në grupe sidomos në lëndët si edukim figurative apo muzikor, [mungojnë atelie} enkas në përmbushje të programit specifik*
5. Për rekomandimin e fundit - Në evidencat e paraqitura rezulton se në vitin akademik 2015-2016 Departamenti i Shkencave të Edukimit ka patur staf PAE 8 vetë nga të cilët 6 me tituj dhe grada shkencore dhe staf PAK 11 vetë nga të cilët 3 me grada shkencore, në total 19 vetë nga të cilët 9 me tituj dhe grada shkencore. Në vitin akademik 2018-2019, stafi PAE është 8 vetë nga të cilët 3 me gradë shkencore, dhe stafi PAK 3 vetë nga të cilët 2 me gradë shkencore, në total 11 vetë nga të cilët 5 me titull Dr dhe një doktorant. *Konstatohet se nuk ka një rritje në stafin me tituj apo grada shkencore.*

# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

**Programi i studimit** Bachelor në “Arsim parashkollor dhe fillor” ka si mision arsimim me cilësi të lartë, për të përgatitur në nivel Bachelor, studentë të cilët kontribuojnë në mënyrë konstruktive për çështjet e edukimit, çështjet arsimore, kulturore dhe sociale në një kontekst dhe frymë lokale dhe europiane. Fokus i këtij misioni është mbështetja dhe promovimi i cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbim ndaj komunitetit nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale. Misioni dhe vizioni i departamentit që e mbulon këtë program studimi gjendet në faqen zyrtare të institucionit.

Programi ka objektivat të përcaktuara qartë në rregulloren themelore të institucionit dhe synojnë pajisjen e studentit me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit Arsimin Parashkollor dhe Fillor, me aftësi profesionale, me formim qytetar të përgjithshëm, me aftësi të përgjithshme praktike, dhe aftësi për promovim personal. Programi gjithashtu synon arrijtjen e niveleve cilësore të dijes akademike, kompetencave dhe njohurive të aplikuara për studentët, duke mundësuar që ata të përshtaten me kërkesat e tregut të punës, të ndjehen të përbushur nga ana personale. Këto objektiva synohen të arrihen nëpërmjet veprimtarive akademike të formimit të përgjithshëm, të formimit karakterizues, dhe aftësisë praktik. Studentët që do të ndjekin këtë program studimi parashikohet t’i realizojnë këto veprimtari gjatë tre viteve akademike kundrejt një sasive prej 180 ECTS.

Me mbarimin e programit të studimit studentët mund të punësohen si mësues në ciklin parashkollor, apo si ndihmës mësues në institucione të ndryshme arsimore private dhe publike, specialist arsimit apo anëtar të strukturave drejtuese të institucioneve arsimore publike dhe private. Programi ua mundëson të vijojnë më tej studimet e tyre në programe Master Profesional në Arsim Fillor për t’u formuar më pas si mësues të arsimit fillor.

*Organigrama e Institucionit i jep mundësi që të përmbushë qëllimet dhe misionin për të cilin është ngritur.*

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p><b>Rezulotojnë</b> përputhje të qëllimit të programit me misionin e institucionit, si institucion që investon qëllimshëm në çështje të edukimit dhe mirëarsimit konform vlerave kombëtare dhe universale.</p> <p><b>Konfirmojmë</b> qartësinë e programit dhe përthyerjen e tij në objektiva të shtrira në kohë përgjatë semestrave, të cilat synojnë formimin e studentëve dhe profilin e tyre si edukatorë dhe mësimdhënës në dy grup-mosha specifike shkollore. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë në rregulloren themelore të institucionit dhe synon arrijtjen e dijes akademike, kompetencave dhe njohurive të aplikuara për studentët, duke mundësuar që ata të përshtaten me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><b>Programi rezonon</b> me nevojat e tregut, të cilat ndihen në nevojë për më shumë ekspertizë në ciklin parashkollor, fillor në edukim dhe arsim.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p>	<p>Program BSc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” është në rezonancë me strategjinë e institucionit. Është ndër programet e para të licencuara dhe të akredituara të vetë institucionit.</p>

**Kriteri 3** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

**Referuar** dokumentacionit ky program, arrin përmbushjen me dije bazale të studentëve në çështjet e edukimit dhe arsimit që çojnë në mirë edukim dhe formim të mjaftueshëm të dy grupmoshave respektive.

**Konfirmojmë që: Programi** “BSc në Arsim Parashkollor dhe Fillor” orientohet nga tendencat e zhvillimit ekonomik të vendit. Kjo, reflektohet në kurrikulën e programit të studimit dhe programet e lëndëve përkatëse, formuluar nga institucioni në kapitullin “Qëllimet dhe Objektivat” e programit.

## II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

### Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

**Kriteri 1** Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

**Konfirmojmë** nevojat e tregut për cilësi në edukimin dhe shkollimin e fëmijëve në parashkollor dhe fillore. Ka një studim të institucionit, por kjo nevojë është e konfirmuar në nivel vendi. Ajo që pritet është cilësia e kërkuar e të diplomuarëve në dhe rreth edukimit të këtyre dy grupmoshave.

Nga vizita na rezulton se institucioni është i qartë për mundësitë e punësimit të të diplomuarëve në këtë program, siç janë kolegjet, ku dhe janë të përfshira të dy grup-moshat. Numri i studentëve të regjistruar në program është relativisht i vogël, ndoshta kjo bën të mundur dhe punësimin e tyre.

**Konfirmojmë** se institucioni ka bërë një analizë të detajuar të tregut dhe i ka të evidentuara me shifra edhe numrin e studentëve në programet e ngjashme të institucioneve simotra, dhe bazuar në këtë studim është kërkuar rishikimi i këtij programi në studime bachelor në arsimin parashkollor dhe fillor si programe të ndara, dhe një program studimi i nivelit master për arsimin fillor.

Për riorganizimin e programit të studimit, KUB i është drejtuar MASR me shkresa zyrtare për këtë riorganizim. Konkretisht:

- Me shkresë Nr 99/1, datë 29.10.2017 “Kërkesë për riorganizimin e 6 (gjashtë) programeve”, shkresë në të cilën kërkohet riorganizimi i programit Bsc në arsim fillor.
- Me shkresë nr 19, datë 09.02.2018 “Kërkesë për hapje programesh të reja”, është kërkuar hapja e programit Bachelor në Mësuesi Arsim parashkollor
- Me shkresë nr 29, datë 28.01.2019 “hapja e programeve të reja: I është kërkuar MASR hapja e Bachelor në Mësuesi Arsim Parashkollor dhe Master Profesional në Mësuesi Arsim Fillor.

Gjatë takimeve në Institucion, GVJ ju komunikua se është kërkuar riorganizimi i programit aktual në 2 programe të tjera Bsc (Arsim parashkollor) dhe (Arsim Fillor), ndërkohë që nga sa më sipër është kërkuar në fakt vetëm riorganizimi i programit Bsc në Arsim Fillor.

### Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

**Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;

**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Program Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” nuk bie ndesh me interesat kombëtare.

**E konfirmojmë** se program i lartpërmendur ruan vlerat dhe ndjeshmërinë kombëtare për mësuesin dhe edukatorin si institucion. Institucioni ka një strategji të veten lidhur me

ruajtjen e vlerave kulturore kombetare nepermjet dhenies së bursave studentëve nga trojet shqipfolëse.

### Konkluzionet e vlerësimit:

1. Program BSC në Arsim Parashkollor dhe Fillor është në rezonancë me strategjinë e institucionit. Është ndër programet e para të licencuara dhe të akredituara të vetë institucionit.
2. Institucioni është i qartë për mundësitë e punësimit të të diplomuarëve në këtë program, siç janë kolegjet, ku dhe janë të përfshira të dy grup-moshat. Numri i studentëve të regjistruar në program është relativisht i vogël, ndoshta kjo bën të mundur dhe punësimin e tyre. Ky program studimi për kohën kur është hapur ka patur më shumë mundësi punësimi, {vetëm 9 janë të punësuar}, por me Ligjin e ri të Arsimit të Lartë, ku kërkohet domosdoshmërisht për ciklin fillor niveli i dytë i studimit siç edhe deklarohet nga drejtuesit mund të bjerë numri i studentëve, ndaj është punuar për ristrukturimin e këtij programi studimi, janë dorëzuar dosjet e programeve të reja të studimit por deri tani nuk ka një miratim nga MASR.
3. Institucioni ka një strategji të qartë për ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare të pasqyruara në këtë program studimi.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti Filologjisë dhe Edukimit është një nga dy Fakultetet e Kolegjit Universitar Bedër. Fakulteti ka në përbërjen e tij tre departamente: 1. Departamenti i Shkencave Kompjuterike; 2. Departamenti i Shkencave të Edukimit; 3. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze: Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata. Departamenti mbulon programet e studimit të nivelit bachelor dhe master shkencor

Të dhëna të përgjithshme për organizimin e KUB, bëhen publike dhe në website, që institucioni publikon çdo fillim viti akademik. Baza e të dhënave si dhe e stafeve akademike dhe administratës së institucionit ndodhet e dokumentuar dhe rifreskohet çdo fillim viti akademik nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila funksionon si hallkë ndërlidhëse midis Fakulteteve, Departamenteve dhe të gjitha njësive të tjera bazë që funksionojnë në KUB sipas Statusit dhe Rregullores së Institucionit.

Dep. Shkencave të Edukimit, është dhe struktura akademike ku përmbushet programi Bsc në "Arsim Parashkollor dhe Fillor" Stafi i Departamentit përgjegjës, për vitin akademik 2018-2019 paraqitet: 8 PAE (1 Prof As; 3 Dr; 1 Dr në proces; 3 Msc) dhe 3 PAK (2 Dr; 1 Msc)

Për vitet e tjera Akademike, stafi në Departament paraqitet si më poshtë:

Viti Akademik 2017-2018 – 8 PAE (1 Prof As; 3 Dr; 1 Dr në proces; 3 Msc) dhe 5 PAK (2 Dr; 1 Dr në proces; 2 Msc)

Viti Akademik 2016-2017 – 7 PAE (2 Prof. As; 3 Dr; 1 Dr në proces; 1 Msc) dhe 3 PAK (3 Msc)

Viti Akademik 2015-2016 – 8 PAE (3 Prof. As; 3 Dr; 2 Dr në proces) dhe 11 PAK (1 Prof. As; 2 Dr; 2 Dr në proces; 6 Msc)


Viti Akademik 2014-2015 – 7 PAE (2 Prof. As; 1 Dr; 3 Dr në proces; 1 Msc) dhe 9 PAK (1 Prof. As; 1 Dr; 4 Dr në proces; 3 Msc)

Viti Akademik 2013-2014 – 9 PAE (1 Prof. Dr; 4 Dr; 4 Msc) dhe 11 PAK (1 Prof. As; 2 Dr; 1 Doc; 5 Msc; 2 MA)

Referencë, Anekse, tabela 1-12, ku janë paraqitur të dhëna për Stafin në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit me Departamentet përbërëse të tij (përfshirë edhe Departamentin e Shkencave të Edukimit) në vite.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit.



Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, përmbush misionin dhe qëllimet e shtrirë në tri Departamente: Departamenti Shkencave të Edukimit, Departamenti i gjuhës dhe letërsisë angleze, Departamenti i Shkencave kompjuterike. Fakulteti funksionon në përmbushje të legjislacionit në R.Shqipërisë, dhe konform rregullores së brendshme të institucionit.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Shkencave të Edukimit ku përmbushet programi Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” ka një staf akademik PAE prej 8 persona: Pjesë e këtij stafi është edhe Dekani i Fakultetit dhe ka titullin Profesor i asociuar. Përgjegjësi i Dep. Edukimit, gëzon titullin Dr, 2 lektorë të tjerë kanë titullin Dr dhe 1 është doktorante në proces, tre janë me titullin Msc. Personel akademik me kontratë (PAK) janë 3 prej të cilëve 2 me gradën Dr.

Të dhënat e mësipërme lidhur me stafin akademik të departamentit janë të vitit 2018-2019. Në vitin 2017 – 2018 stafi akademik ishte po 8 vetë me të njëjtën numër titujsh dhe gradash shkencore, por me një antarë të tij të ndryshuar. Në vend të zotit L. C. lektor i larguar është Znj. J. T. lektor me të njëjtën gradë shkencore Dr. Ndyshon personeli akademik me kontratë i cili nga 5 vetë në 2017-2018 bëhet 3 vetë në 2018-19, që është aspekt pozitiv për përmbushjen e standarteve. Po kështu ka edhe prurje akademike, nga departamente të tjera që mbulojnë lëndë në këtë program që mendojmë se ndikon në cilësinë e realizimit të tij.

*Të dhënat për Raportin e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK) si dhe Personeli ndihmës akademik, ndër vite, janë paraqitur në Anekse, Tabela 13-18*

*Të dhëna për moshën e PAE dhe Personelit Administrativ, si dhe moshën e Personelit akademik me Kontratë, për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019, paraqiten në Anekse, tabela 19 dhe 20*

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e



ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i departamentit që mbulon këtë program studimi për vitin 2018-2019 përbëhet nga personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Në raportin e paraqitur nga grupi i vlerësimit të brendshëm, Evidenca 12, por edhe referuar tabelave në Anekse (tabela 21-26) raporti mes stafit me kohë të plotë dhe stafit me kohë të pjesshme të angazhuar në këtë program studimit, jepet më poshtë:

Viti akademik 2018-2019 – 11 PAE/4 PAK.

Mbulimi i programit në përqindje sipas numrit total të personelit akademik është 73.3% PAE

Viti akademik 2017-2018 – 12 PAE/4 PAK

Mbulimi i programit në përqindje sipas numrit total të personelit akademik është 75% PAE

Viti akademik 2016-2017 – 12 PAE/5 PAK

Mbulimi i programit në përqindje sipas numrit total të personelit akademik është 70% PAE

Viti akademik 2015-2016 – 9 PAE/8 PAK

Mbulimi i programit në përqindje sipas numrit total të personelit akademik është 52% PAE

Viti akademik 2014-2015 – 12 PAE/7 PAK

Mbulimi i programit në përqindje sipas numrit total të personelit akademik është 63% PAE

Viti akademik 2013-2014 – 12 PAE/10 PAK

Mbulimi i programit në përqindje sipas numrit total të personelit akademik është 54% PAE

Vërehet se ngarkesa në masën 70% nga të brendshëm është mbuluar në tre vitet e fundit akademike.

Ngarkesa e pedagogëve të lëndëve të angazhuar në këtë program studimi na u dha nga Institucioni si informacion gjatë vizitës, i ndarë në semestrin e vjeshtës dhe në semestrin e pranverës. (Shiko Anekse, tabela 23/1 dhe tabela 23/2). Në semestrin e pranverës pedagogët e lëndës paraqiten me një ngarkesë në orë që varion nga 196 orë maksimalisht (Msc U.K) deri në 42 orë minimalisht nga disa pedagogë. Ndërsa ngarkesa e këtyre pedagogëve të cilët janë angazhuar edhe në programet të tjera të ofruara nga KUB, varion sërish nga 196 orë -42 orë.

Në semestrin e vjeshtës, pedagogët e lëndës paraqiten me një ngarkesë në orë që varion nga 126 orë maksimalisht (Dr A.O. dhe Msc U.K) në 42 orë minimalisht (janë disa pedagogë më këtë ngarkesë). Ndërsa ngarkesa e këtyre pedagogëve të cilët janë angazhuar edhe në programet të tjera të ofruara nga KUB, varion nga 238 orë (Dr J.T) në 42 orë (Dr M.L – PAK).

Gjithsej në të dy semestrat (Pranverë + vjeshtë), ngarkesa në të gjitha programet e ofruara nga KUB për stafin e këtij programi me kohë të plotë, varion nga 392 orë (DR. L.C) në 168 orë (Msc E.M)

Stafi në vite në programin e studimit, e shprehur me tituj dhe grada si për personelin akademik efektiv dhe për personelin akademik me kontratë jepet më poshtë:

- Viti akademik 2018-2019  
11 PAE – 1 Prof. As; 5 Dr; 1 Dr në process; 4 Msc  
4 PAK – 2 Dr; 2 Msc
- Viti akademik 2017-2018  
12 PAE – 1 Prof. As; 6 Dr; 1 Dr në process; 4 Msc  
4 PAK – 1 Dr; 1 Dr në process; 2 Msc
- Viti akademik 2016-2017  
12 PAE – 2 Prof. As; 5 Dr; 2 Dr në process; 3 Msc  
5 PAK – 2 Dr në process; 3 Msc
- Viti akademik 2015-2016  
9 PAE – 1 Prof. As; 5 Dr; 1 Dr në process; 2 Msc  
8 PAK – 2 Dr; 2 Dr në process; 4 Msc
- Viti akademik 2014-2015  
12 PAE – 1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 6 Dr; 2 Dr në process; 1 Msc  
7 PAK – 2 Prof. As; 2 Dr; 1 Dr në process; 2 Msc
- Viti akademik 2013-2014  
12 PAE – 1 Prof. Dr; 1 Prof. As; 5 Dr; 2 Dr në process; 3 Msc  
10 PAK – 1 Prof. Dr; 5 Dr; 2 Dr në process; 2 Msc

Në raport jepet një personel administrative pa ndonjë titull apo gradë shkencore.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Referuar RVB, faqe 23, KUB ka paraqitur të dhëna sërish për Departamentin. Në fakt në këtë rubrikë kërkohen të dhëna për stafin në program studimi.

Numri i lëndëve rezulton se është 37 por kjo ngarkesë mbulohet nga ky numër personeli që thamë më lart. Kjo do të thotë se secili pedagog mbulon më shumë se një lëndë në këtë program studimi. Ky staf lidhur me kualifikimin që ka është pothuajse i njëjtë me stafin e vitit 2017-2018, që tregon se nuk ka ndonjë ndryshim esencial gjatë këtyre dy viteve në kualifikimin e personelit.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Gjatë vizitës u konstatua se pedagogët që mbulojnë programin e studimit për vitin akademik 2018-2019 në tërësi janë një staf 15 pedagogësh, dhe kualifikimi i tyre është 1 me titull shkencor Prof.as.; 7 me gradë shkencore Dr; 1 Dr në process dhe 6 me Msc.

Ndonëse është pasqyruar në raport nuk na është prezantuar asnjë staf ndihmës për këtë program studimi.

Të dhënat sipas seksit

Gjatë vizitës u konstatua se raporti sipas seksit i personelit që mbulon këtë program studimi për vitin aktual akademik është 6 meshkuj dhe 9 femra.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Gjatë vizitës u konstatua se moshja e personelit që mbulon këtë program studimi është relativisht e re dhe është në rrugën e zhvillimit profesional dhe të kualifikimit.

Kontratat e punës, procedurat.

Konstatuam se ka procedura për rekrutimin e stafit, për këtë ngrihet komisioni për rekrutimin e tij. Komisioni bën renditjen e kandidaturave dhe ia propozon rektorit për miratim shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Midis tri kandidaturave, Rektori miraton një prej tyre. Vendimi i Rektorit i dergohet për ndjekje Zyrës së Burimeve Njerëzore, dhe Zyrës së Finances si dhe për dijeni Fakultetit dhe Njesisë bazë për ndjekje procedurale. Kandidati Fitues sjell dokumentet e përcaktuara tek lista e të dhënave individuale të personelit. Zyra e Burimeve Njerëzore përgatit Emërimin, ky document firmoset nga Rektori. Zyra e Burimeve Njerëzore informon të gjithë stafin nëpërmjet e-mail mbi emërimin e ri.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nuk na është prezantuar ndonjë staf ndihmës që lidhet me programin e studimit me përjashtim të sekretarisë mësimore si dhe të pedagogëve të cilët mbulonin detyra të zyrave të caktuara si këshillimit akademik, këshillimi i karrierës, etj.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b> <b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë; <b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Nga vizita në institucion na <b>rezulton</b> se rekrutimi i stafit bëhet përmes procedurave ligjore korrekte. Ky process ndjek ligjin dhe rregulloren e brendshme deri ne emërimin e stafit. Zyra e personelit dhe e financës ndjek në detaj çdo emërim deri në konfirmimin në detyrë. Procedurat e rekrutimit janë transparente dhe nuk konstatuam që kishte shmangie apo problematika. <b>Rezulton</b> se 73.3% e stafit të angazhuar në përbushje të programit është staf i brendshëm për vitin akademik 2018-2019.

<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p><b>Rezulton</b> se institucioni ka një rregullore të veçantë “Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e përfomancës së stafit” mbi të cilën bëhet jo vetëm pranimi por edhe vlerësimi i performancës së personelit.</p> <p><b>Konfirmojmë</b> se institucioni ka një bazë të dhënash të njoftimeve për punësime të stafit akademik dhe administrativ, si dhe të procedurave të realizimit të procesit të pranimit të kandidatëve.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p><b>Rezulton</b> që, Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrative që mbulon programin e studimit. Për secilin pedagog ka një zë të veçantë në faqen zyrtare të Institucionit.</p> <p><b>Institucioni</b> publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><b>Institucioni</b> angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor”, një nga pedagogët, është në prag të marrjes së titullit “Doktor”</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Nga vizita në institucion <b>nuk na rezulton</b> që të ketë mjedise laboratorike/atelje në funksion të programit Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor”, enkas në funksion të përmbushjes së programit, detyrim që institucionit i është lënë nga procesi i akreditimit të kaluar.</p> <p><b>Na rezulton</b> që ka një angazhim serioz të stafit të brendshëm në përmbushje të programit dhe shfrytëzim të kapaciteteve egzistuese.</p> <p><b>Konfirmojmë</b> nga vizita dhe bashkëbisedimi me zyrën e këshillimit të studentëve se kishte angazhim serioz të stafit për të orientuar studentët drejtë praktikave profesionale, por nuk konstatoam që kjo të ishte e rregulluar me marrëveshje specifike ndërinstitutionale.</p> <p>Në këtë program studimi si edhe në programet e tjera ka këshillues akademik për orientimin e studentëve, e dhënë informuese që u siguroi nga takimi me studentët.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p><b>Kontaktuam</b> me faktin që organizohen programe për kualifikimin e profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Nevojat e këtyre kualifikimeve identifikoheshin nga departamentet dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, kjo e fundit, përpilonte agjendën e veprimtarive ku edhe ftoheshin trainer vendas dhe të huaj.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p>	
<ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Rezulton</b> se rekrutimi i stafit bëhet përmes procedurave ligjore korrekte. Ky process ndjek ligjin dhe rregulloren e brendshme deri në emërimin e stafit. Zyra e personelit dhe e financës ndjek në detaj çdo emërim deri në konfirmimin në detyrë.</li> <li>Nga vizita në institucion <b>nuk na rezulton</b> që të ketë mjedise laboratorike/atelje në funksion të programit Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor”, enkas në funksion të përmbushjes së programit, detyrim që institucionit i është lënë nga procesi i akreditimit të kaluar. Pedagogët deklarojnë se brënda ambienteve ku bëjnë mësim realizojnë edhe punimet laboratorike sidomos në lëndën e edukimit artistik.</li> </ol>	

**3. Konfirmojmë** nga vizita dhe bashkëbisedimi me zyrën e këshillimit të studentëve se kishte angazhim serioz të stafit për të orientuar studentët drejtë praktikave profesionale, por nuk konstatojmë që kjo të ishte e rregulluar me marrëveshje specifike ndër-institucionale. Ka këshillues akademik për orientimin e studentëve si në fillimin e vitit ashtu edhe në orientimin e tyre drejt përzgjedhjes së lëndëve në planin mësimor, praktikës profesionale, e dhënë kjo nga takimi me studentët.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Gjatë vizitës në ambientet e këtij institucioni u konstata se kishte ambiente të përshtatshme për realizimin cilësor të këtij programi. Ambientet e mësimit ishin të paisura me kompjutera, aparate projeksioni dhe në disa klasa edhe smart boards. Ambientet e bibliotekës ishin të përshtatshme dhe kishin një fond të mjaftueshëm librash për programin e studimit në fjalë. Kanë një sallë shumë të mirë për organizim të aktiviteteve të ndryshme shkencore edhe artistike si dhe ambiente të tjera në ndihmë të studentëve.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Mjediset për Programin e studimit
- Salla për leksione 1
  - Salla për aktivitete promovuese 1
  - Laboratorë informatike - 1
  - Salla interneti - 1
  - Salla për bibliotekë - 1
  - Mjedis për fotokopjime, librari etj - 1
  - Zyrë informacioni për studentët - 3
  - Nyje hidrosanitare – 3

Ndryshe nga çfarë është deklaruar në raportin e vlerësimit të brendëshëm sallë laboratorit apo edhe për praktikën profesionale nuk është në shërbim të këtij programi studimi.

- Mjediset për stafin:
- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
  - Zyra për sekretarinë mësimore
  - Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
  - Zyra për personelin akademik

*Referohu Anekse, tabela 27*

##### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbyllja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Titujt akademikë dhe mësimore në funksion të programit <b>gjenden të listuar në çdo syllabus</b> respektivisht. Gjë që e mirëorienton lektorin dhe mbi të gjitha lehtëson studentin të orientohet në literaturën respective.</p> <p>Biblioteka <b>rezulton</b> të jetë e pasur dhe në tituj elektronike dhe në tituj fizikë. Biblioteka funksionon në formë elektronike dhe duket mjaft në funksion të studentëve, të cilët ishin të aklimatizuar me mjediset dhe procedurat e kërkimit në mjediset e saj.</p> <p>Biblioteka <b>ka periodikë në funksion të programit</b> si dhe disponon botimin me ISSN të institucionit ku janë të përfshira dhe artikujt në shkencat e Edukimit. Studentët dhe pedagogët <b>kanë akses në bibliotekën on-line Ebsco-Host</b>. Mjediset e bibliotekës <b>ishin në hapësira të mjaftueshme</b> shfrytëzimi dhe studentët ishin të mirë orientuar në të. Mjediset e bibliotekës <b>ishin te hapura për gjatë gjithë kohës</b>.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p><b>Konfirmojmë se</b> institucioni përmbush programin në hapësira fizike të mjaftueshme dhe të shëndetëshme në pikëpamjen e higjenes. Ka në sasinë e nevojshme, klasa ku zhvillohet mësimi, mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit.</p> <p><b>Rezulton se</b> pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me teknologjinë. (kompjutera; aparate projeksioni, smart boards, etj.)</p> <p><b>Rezulton se</b> institucioni ka mjedise të shumta për realizimin e programeve të studimit që ofron por <b>nuk rezulton se</b> institucioni ka mjedise për realizimin e praktikave profesionale të këtij program studimi, pasi <b>për vetë natyrën e programit</b> praktikat zhvillohen në ambiente shkollore dhe në kopshte.</p> <p>Departamenti <b>ka marrëveshje mirëkuptimi</b> për realizimin e praktikave profesionale me institucione të tjera. Konstatuam raste kur disa studentë, zhvillojnë praktikat profesionale gjatë periudhës së verës në ambientet e kopshteve të cilët e kërkojnë këtë shërbim. Kjo nuk konfirmon se praktikat profesionale janë të mirëregulluara në gjithëkuptimësinë e tyre.</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p>	
<ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Konstatojmë se</b> institucioni i përmbush kriteret e kerkuara, për literaturën bazë dhe ndihmëse për studentët nëpërmjet bibliotekës, ku ofrohen tituj në përputhje me programin e studimit si fizikisht edhe online.</li> <li><b>2. Institucioni ofron</b> mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e veprimtarisë akademike shkencore dhe angazhohet për ndjekjen dhe përmirësimin e tyre nëpërmjet përmirësimit të teknologjisë.</li> <li>Departamenti <b>ka marrëveshje mirëkuptimi</b> për realizimin e praktikave profesionale me institucione të tjera. Konstatuam raste kur disa studentë, zhvillojnë praktikat profesionale gjatë periudhës së verës në ambientet e kopshteve të cilët e kërkojnë këtë shërbim. <u>Kjo nuk konfirmon se praktikat profesionale janë të mirëregulluara në gjithëkuptimësinë e tyre.</u></li> </ol>	

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar "Bedër" është institucion privat jofitimprurës. Pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit vijnë nga pagesat e studentëve dhe donacionet. KUB ka siguruar donacione nga institucione të ndryshme. Institucioni gëzon të drejtën të pranojë mbështetje financiare dhe materiale që lidhet me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Të hyrat dhe të dalat financiare të institucionit kontrollohen në mënyrë të rregullt nga institucionet kompetente shtetërore. Institucioni mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Përveç kësaj, institucioni merr ndihmë për të gjitha çështjet financiare, tatimore, çështjet e kontabilitetit nga ekspertë kontabiliteti të jashtëm. Kostoja për student në vitin akademik 2017-2018 sipas RVB ishte 153 619 lekë. Menaxhimi financiar i institucionit është nën kontrollin e Fondacionit Hafiz Ali Korça dhe administrohen në bashkëpunim me administratorin e Kolegjit Universitar Bedër.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim ( 1,312,193 për vitin 2016-17, ndërsa për dy vitet e fundit ska. Nga takimi me pedagogë raportohet se ato kanë në dispozicion një shumë prej 700 euro për veprimtari shkencore, por që nuk rezultojnë të dokumentuar.)
- Konsulencat, shërbimet ( 9,027,774 për vitin 2017-18 dhe 376,050 për vitin 2018-19 )
- Tarifat për studentë dhe gjatë shkollimit (64,625,526 për vitin 2017-18 dhe 28,011,220 për vitin 2018-19 )
- Sponsorizimet ( ska )
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj 28,011,220 për vitin 2017-18 dhe 1,224,600 për vitin 2018-19
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) ska

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet për studentë dhe kosto e studimit, gjatë tre viteve të fundit kanë një rënie nga 215,637 në vitin akademik 2015-16, në 153 619 në vitin akademik 2017-18, gjë e cila flet për një ulje të shërbimeve ndaj tyre, por që institucioni deklaron se pavarësisht kësaj shërbimet ndaj studentëve janë të mjaftueshme për të realizuar këtë program studimi.

*Reference, Anekse, tabela 28 dhe tabela 29*

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; <b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; <b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe	<b>Rezultoni se në institucion ka një njësi auditimi të përvitshëm nga fondacioni ku bën pjesë edhe Kolegji Beder i cili kontrollon situatën financiare të tij bazuar në legjislacionin në fuqi.</b> <b>Rezultoni se institucioni përgatit një raport vjetor financiar i cili i dërgohet MASR çdo vit ky përfshihen buxheti i një</b>

kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	viti më parë, projektbuxheti i vitit të ardhshëm dhe ai afatmesëm. Në tabelat e paraqitura rezultojn se institucioni ka një pasqyrë të qartë të donacioneve dhe granteve në funksion të realizimit të programit të studimit.
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p><b>Konfirmojmë se</b> institucioni ka një raport financiar të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët.</p> <p><b>Konfirmojmë se</b> institucioni disponon dhe analizon situatën financiare nëpërmjet raporteve që ruan dhe i dërgon MASR-së.</p> <p><b>Rezultoni se</b> institucioni ka burime financiare për të bërë të mundur realizimin e programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, por, <b>duhet të pranojmë se në tre vitet e fundit të ardhurat e institucionit janë në ulje.</b></p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Konfirmojmë se</b> institucioni ka një raport financiar të detajuar të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët nga donacione apo shoqata.</li> <li><b>Konfirmojmë se</b> institucioni ka burime financiare të mjaftueshme për të bërë të mundur realizimin e programit të studimit. Institucioni njih dhe planifikon situatën financiare, por <b>rezultoni se në tre vitet e fundit të ardhurat janë në ulje.</b></li> </ol>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni ka ngritur një sistem funksional për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e brendshëm si të programit të studimit ashtu edhe të tërësve veprimtarisë mësimore në institucion. Funksionon komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë që përcakton edhe strategjitë dhe procedurat që ndiqen për sigurimin e cilësisë dhe të vlerësimit të performancës akademike të personelit, nëpërmjet funksionimit të NJSBC-së si dhe të komisioneve ad-hoc që ngrihen për aspekte të veçanta të veprimtarisë të institucionit. Si për njësinë ashtu edhe për çdo aspekt të veprimtarisë që lidhet me sigurimin e cilësisë dhe rritjen e performancës së personelit ka rregullore të veçanta.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët

*Anketime me studentë bazuar në rregulloren e anketimeve dhe vlerësimeve të njësisë bëhen në çdo fund semestri për të gjitha lëndët dhe me të gjithë studentët, pasi ka edhe një numër të vogël. Ato bëhen on-line dhe anonime*

- Sa studentë janë anketuar

Janë anketuar të gjithë studentët që kanë dëshiruar

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë.

Janë konstatuar probleme që lidhen me cilësinë e dobët në rezultate dhe performancë jo në cilësinë e kërkuar në mësimdhënie, mospërputhje adeguate të pedagogut në rrafshin akademik me profilin e lëndës që zhvillon, gjë që, që ka ndikuar në raste të caktuara në ulje të cilësisë

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Rezultoni se për pedagogë të veçantë ka patur edhe largime nga puna apo edhe ndryshime në ngarkesat e pedagogëve për lëndë të caktuara në të cilat ato nuk kanë patur arritje. Janë bërë herë pas here përmirësime në planin mesimor sipas rekomandimeve të studentëve apo edhe të ekspertëve që kanë bërë vlerësimin.etj.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Krahas NJSBC, në raste të nevojshme dhe për fusha në të cilat nevojitet një ekspertizë e veçantë, funksionojnë komisionet ad-hoc të përbërë nga pesë anëtarë, dhe kanë një mandat të përcaktuar. Ato japin rekomandime dhe kontribut në fusha për të cilat nevojiten njohuri të veçanta teknike, duke vendosur marrëdhënie me njësitë akademike dhe administrative, gjatë procesit të vlerësimit akademik vlerësimit institucional, vlerësimit të jashtëm, etj.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Ka një komision të përhershëm për sigurimin e cilësisë i cili përcakton edhe strategjitë dhe procedurat që ndiqen për sigurimin e cilësisë. Ka rregullore për aspekte të caktuara të sigurimit të cilësisë si rregullorja për organizimin administrativ; rregullore e anketave dhe vlerësimit; rregullore e studimeve; rregullore e funksionimit të njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë etj. Rregullorja e NJSBC rregullon organizimin dhe administrimin e njësive e cila është organi përgjegjës për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ, për përmirësimin e cilësisë.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Bëhet një analizë pune e departamentit për rrezultatet në procesin mësimor. Hartohet një raport vjetor i punës që i paraqitet Senatit të institucionit. Ka një formular vlerësimi për pedagogët për tërë aspektet e veprimtarisë të tyre në shërbim të rritjes së cilësisë dhe performancës së tyre. Bëhen anketime me studentë. Ajo që mund të thuhet se ndonëse ka një përmisim të punës për disa aspekte të vlerësimit nuk ka për disa të tjerë si për shembull për përmisimin e vazhdueshëm të planit mësimor për të qënë koherent me urdhëresat e MASR-se dhe kërkesat e kohës.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Rezultoni se NJSBC pas vlerësimeve të bëra bën një analizë të hapur me gjithë personelin akademik dhe bazuar në këtë analizë hartohet një plan veprimi i departamentit për përmisimin e punës.

Në praktikën e institucionit ka edhe urdhëra për ngritjen e komisioneve të auditimit të dokumentacionit të departamentve (të cilat bëjnë verifikimin e dokumentacionit bazuar në ligjshmërinë dhe rregulloren e institucionit dhe dalin me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e punës.

Reference, Aneks, tabela 30

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	<b>Rezultoni se</b> institucioni ka një sistem funksional për vlerësimin e programit të studimit dhe përdor një tërësi instrumentash vlerësimi.



<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p><b>Rezulton se</b> ka një raport vlerësimi të paraqitur para Senatit të institucionit çdo vit mbi bazën e tërësisë së vlerësimeve që bëhen nga departamentet, njësitë përkatëse të sigurimit të cilësisë, dhe mbi bazën e kësaj përcaktohen edhe detyrat për përmisim të punës.</p> <p><b>Rezulton se</b> institucioni ka një sistem informimi brënda institucionit për publikimin e treguesve të saj lidhur me procesin mësimor e rregulluar kjo edhe me akte rregullore të ndryshme. <b>Por nuk rezulton se bëhen publike</b> këto rezultate në faqen e saj zyrtare apo në ndonjë mjet tjetër informimi që ajo ka.</p> <p><b>Konfirmojmë se</b> institucioni përdor si metoda të tërthorta ashtu edhe të drejtpërdrejta për vlerësim. Kjo është e sanksionuar në rregullore të veçanta dhe njësi të cilat monitorojnë këtë proces.</p>
--	---

### VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

#### Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p><b>Konfirmojmë se institucioni përgjithësisht</b> i plotëson standarde dhe kjo është pasqyruar edhe në akreditimin që është bërë në këtë institucion në vitin 2013 nga APPAL dhe 2017 nga agjensia britanike QAA në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p><b>Konfirmojmë se</b> institucioni përdor një tërësi instrumentash dhe njësisish, të cilat veprojnë bazuar në rregullore dhe urdhëresa për sigurimin e cilësisë.</p> <p><b>Rezulton se</b> institucioni ka njësi dhe komisione të ngritura, ka një bashkëpunim mes këtyre strukturave për shqyrtimin miratimin dhe përmisimin e programeve të studimit, <i>por mendojmë se në këtë drejtim duhet të jënë më koherent me udhëzimet e MASR-së dhe kërkesat e kohës.</i></p> <p>Rezulton se institucioni ka një strategji që i jep mundësi për një vazhdimësi në procesin e sigurimit të cilësisë, e shprehur kjo në një seri manualesh që vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit lidhur me këtë problem.</p>
---	---

#### Konkluzionet e vlerësimit:

- Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur, vizitën e bërë në institucion mund të **arrijmë në konkluzionin se institucioni ka një tërësi instrumentash dhe njësisish për të garantuar sigurimin e cilësisë.** Ka hartuar rregullore dhe urdhëresa që ndihmojnë këtë proces, ka bërë të mundur vazhdimësinë e këtij procesi të sigurimit të cilësisë nëpërmjet strategjive që ka hartuar.
- Por mendojmë **se disa mangësi të konstatuara në programin mësimor** si dhe në mos përmirësimin e tij bazuar në udhëzimet e MASR-së, në ngarkesat e pedagogëve me lëndë jashtë profilit, **tregojnë se duhet bërë më shumë konkretisht.**

3. Istitucioni ka njësi dhe komisione të ngritura, ka një bashkëpunim mes këtyre strukturave për shqyrtimin miratimin dhe përmisimin e programit të studimit, por mendojmë se, në këtë drejtim duhet të jenë më koherent me udhëzimet e MASR-së dhe update të programit konform akteve nënligjore.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Bachelor në “Arsim parashkollor dhe fillor” merr përsipër përgatitjen e studentit për dy ciklet e arsimit në vendin tonë atë të arsimit parashkollor dhe fillor, duke e parë si një mundësi më shumë punësimi. Programi i studimit është përcaktuar sipas sistemit të Bolonjës të ketë 180 ECTS, por struktura e tij dhe kalkulimi i bërë mundëson që studenti të dalë ose me më pak ose më shumë kredite dhe kjo për shkak të lëndëve me zgjedhje të cilat nuk kanë kredite të njëjta. Në vitin e parë semestri parë, lëndët me zgjedhje janë me 6, 5 dhe 4 kredite. Në program studimi nuk ka orë të përcaktuara për seminare apo praktika lëndore sipas udhëzimeve të MASR-së dhe rekomandimeve të lëna nga akreditimi i vitit 2013. Gjatë vizitës u arsyetua nga stafi akademik se, aplikohet gërshëtimi i dijes teorike me atë aplikative gjatë procesit mësimor, argumente të cilat nuk e justifikojnë faktin që në program dhe në sylabuset respektive të lëndëve nuk gjëndet raporti i domosdoshëm teori-praktike. Si rrjedhojë e saj edhe në sillabuset nuk ka ndarje të krediteve sipas formave të veprimtarisë, kredite për leksion; kredite për seminar apo veprimtari të tjera, ndonëse këto përmenden në format e vlerësimit të studentëve. Nuk rezulton se ka numër orësh të mjaftueshme për plotësimin e 180 ECTS-ve duke llogaritur 25 orë për kredit (1840 orë auditor + 70 orë provime në auditor +1804 punë e studentit + 625 orë punë individuale provime )

Në planin mësimor ka rreth 36 lëndë dhe si rrjedhojë edhe 36 vlerësime të studentëve që bie ndesh me Udhëzimin e MASR-së, i cili parashikon 22 vlerësime që duhet të ketë një plan mësimor brenda 3 viteve të studimit. Shiko Anekse, Tabela 31

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në “Arsim parashkollor dhe fillor” **kanë të përcaktuara** qëllimet dhe objektivat dhe ka qënë në përputhje më Udhëzimet e MAS në kohën kur është akredituar në vitin 2013, por duhet të ishin bërë ndryshime për tu përshtatur me Udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2017 për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë, për të plotësuar edhe rekomandimet e lëna nga akreditimi i bërë.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
- 1 vit akademik ka 2 semestra
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor
- 1 kredit është llogaritur 25 orë punë e studentit brënda në auditor dhe punë individuale. Këtu janë shtuar edhe orë provime.

- Planin mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë  
Shiko Anekse, Tabela 32

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet orë në auditor **1840** dhe **1805 orë** punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret **ska orë** në auditor dhe **ska orë** punë e pavarur e studentit
- Për Labororetet **ska orë** në auditor dhe **ska orë** punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore **ska orë** në auditor dhe **ska orë** punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale **144 orë** në auditor dhe **81 orë** punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar **ska** në auditor dhe **625 orë** punë e pavarur e studentit

**Deklarohet se ka ka 70 orë në auditor për provime (faqe 47 të RVB-së por nuk është e evidentuar)**

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Janë bërë vetëm *dy ndryshime në planin mësimor krahasuar me programin e licensimit* në lëndët “Komunikim në familje” dhe “Anatomi bazë dhe higjienë në Arsim parashkollor dhe Fillor” nga 4 ECTS 100 orë mësimore janë ndryshuar në 5 ECTS duke rritur numrin e orëve punë individuale jasht auditorit. *Por mendojmë se ndryshimet për tu përshtatur me udhëzimin e MASR-së nr.41 datë 24.01.2018 nuk janë bërë.* Deklarohet se këto ndryshime janë bërë në programin e ri që është dërguar për miratim në MASR ku parashikohet ndarja në dy programe studimi, por që nga dokumentacioni i paraqitur gjatë vizitës në vend nuk rezulton i tillë. *Aneks, Tabela 33*

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotëso Tabelën ne Aneks)

Bazuar në materialin e paraqitur për tre vitet e fundit të këtij program studimi si dhe pedagogët të cilët mbulojnë këto lëndë në planin mësimor, rezulton se: lëndët mbulohen me pedagogë të cilët kanë nivelin e kërkuar të kualifikimit shkencor; plani mësimor mbulohet nga pedagog të brëndëshëm në masën mbi 70%. Por nga shqyrtimi i syllabuseve në vite për pedagogët që mbulojnë lëndët sipas planeve mësimor në vite rezultojnë këto probleme: së pari *nuk ka një qëndrueshmëri në disa lëndë të pedagogëve që e japin lëndën (janë rreth 10 lëndë ku pedagogët ndryshojnë nga viti në vit: së dyti nuk është i njëjtë pedagogu që mbulon lëndën me pedagogun që bën syllabusin (lënda Aftësi komunikimi 2017-18 është mbuluar nga Znj. E. M. ndërsa syllabusi është bërë nga Z. I. E.); dhe së fundi ka pedagogë që janë jashtë profilit (plani mësimor 2017-18 lënda “Arti,muzika dhe loja” mbulohet nga Z. A. O. (me kualifikim Bachelor dhe Master gjuhë angleze dhe doktoratura Shkenca sociale).*

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit **(është i saktë)**
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda **(është i saktë)**
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën **(është i saktë)**
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit **(nuk ka)**
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës **(nuk ka)**
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë **(është i saktë)**
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik **(është i saktë)**
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS **(është i saktë)**
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre **(nuk ka)**
- Format e vlerësimit të studentëve **(është i saktë)**
- Detyrimet e studentit për lëndën **(nuk ka)**
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse **(është i saktë)**

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset në formatin e tyre realizojnë një transparencë për studentin dhe qartësi për pedagogun dhe për njësinë që merret me hartimin dhe kontrollin e realizimit të tyre. Syllabuset i kanë në përgjithësi tërë elementët që kërkohen për të siguruar një vlerësim real dhe me cilësi të studentëve.

Mendojmë se duhet të ishin bërë ndërhyrje për ta ristrukturuar atë sipas Udhëzimit nr.41 datë 24.01.2018.  
 Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p><b>Konfirmojmë se</b> institucioni KUB ofron programin e studimit Bachelor në Arsim parashkollor dhe fillor organizuara në lëndë dhe të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve. <i>Mendojmë se duhet të punojë për ristrukturimin e këtij programi sipas udhëzimeve të fundit të MASR-së.</i></p> <p><b>Rezulton se</b> në planin mësimor sasia totale e krediteve është 180 ECTS <i>por strukturimi i lëndëve me detyrim dhe lëndë me zgjedhje në semestra, sipas krediteve nganjëherë nuk e realizon grumbullimin e krediteve 60 ECTS në një vit akademik.</i></p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p><b>Rezulton se</b> Fakulteti i Filozofisë dhe i Edukimit si dhe Departamenti i Shkencave të Edukimit si strukturë përgjegjëse që ofron këtë program studimi <i>japin informacion të plotë të nevojshëm për programin e studimit.</i> Ka një informacion të tillë në faqen zyrtare të institucionit, si dhe ka për programin edhe këshilluesin akademik, si dhe botohet një manual në ndihmë të studentëve.</p> <p><b>Rezulton se</b> Fakulteti i Filozofisë dhe Edukimit <i>nëpërmjet faqes zyrtare jep një informacion të plotë për lëndët si me zgjedhje ashtu edhe për ato të detyruara.</i></p> <p><b>Rezulton se</b> ka rregullore të institucionit të cilat rregullojnë dhe japin informacion të plotë për të gjitha aspektet e mësimdhënies (rregullorja e organizimit administrativ; rregullorja akademike; rregullorja e programit të studimit etj.</p> <p><b>Konfirmojmë se</b> në faqen zyrtare të njësisë kryesore dhe të departamentit <i>ka informacion mbi syllabuset jo vetëm të vitit akademik në vazhdim por edhe për vitet e kaluara.</i></p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<p><b>1. Përgjithësisht mund të konformojmë se</b> organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit Bachelor në Arsim parashkollor dhe fillor në KUB është në përputhje me sistemin e Bolonjës, udhëzimet dhe kërkesat e MAS-it dhe ka një sistem transparent informimi lidhur me programin e studimit.</p> <p><b>2. Rezulton se në disa aspekte</b> plani mësimor ka nevojë për përmirësime për tu përshtatur me Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2017, dhe udhëzimin e fundit nr 41 datë 24.01.2018 të MASR-së. <u>Duhet të punohet për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga akreditimi i vitit 2013, si dhe mangësive të tjera të konstatuara të përmendura më lart tek vlerësimi i treguesve të matshëm.</u></p>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies,

vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia si aspekt i rëndësishëm për të realizuar qëllimin dhe objektivat e këtij program studimi është në parametra të kënaqshëm. Metodologjitë e mësimdhënese pasqyrohen në syllabuset e lëndëve. Ka një mbështetje logjistike me teknologji bashkohore mësimdhënie, ka një larmi instrumentash kontrolli dhe vlerësimi duke filluar nga pjesëmarrja, detyra kursi, testime gjatë vitit dhe instrumenta të tjerë. Ka një sistem të mirë planifikimi dhe vlerësimi të mësimdhënies si: feedbackun nga studentët, vetvlerësimin e pedagogut sipas formatit standar të ofruar, një tërësi aktiviteteve kualifikuese ndihmëse në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. E vetmja mangësi e konstatuar është mos realizimi i rekomandimit të akreditimit të parë për shtimin e orëve të seminareve, ushtrimeve, dhe praktikave të lëndëve, ndonse u deklarua se kjo është realizuar nëpërmjet gërshtimit të leksionit me forma të tjera mësimore brenda orës së mesimit.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

- Leksione ..... **po**
- Seminare..... **jo**
- Ushtrime..... **jo**
- Laboratore..... **jo**
- Detyre.....**të ingranuara brenda orës së mesimit**
- Praktikë lëndore **organizuar në intershipet e organizuara**
- Praktikë profesionale. **po**

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive pasqyrohen në syllabuset e lëndëve dhe kanë një ndarje në përqindje. Ato variojnë në përqindje të ndryshme sipas lëndëve nga pjesëmarrje në mësim, kuize, projekte, detyra gjatë vitit, testime në formën e provimeve të ndërmjetme, provimi final.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët merrnin pjesë në punën kërkimore me pedagogë janë të pakët në numër rreth 7 studentë, në projekte shkencorë të departamentit janë 50 studentë, në punën shkencore si fakultet janë 60 studentë. Studentët ishin të organizuar në “Klube”, të cilat besojmë se mirëfunksiononin. *Shiko Anekse, tabela 34*

## **9. Studentët**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Studentët e programit BSc “Arsim Parashkollor dhe Fillor” janë të pakët në numër në vite dhe rregjistrimi i tyre është bërë bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe në kriteret specifike që ka KUB. Për të realizuar procesin e rregjistrimit të studentëve, pranë institucioni është ngritur zyra e përzgjedhjes dhe e pranimit të studentëve. Studentët që janë rregjistruar në vite kanë një notë mesatare të shkollës së mesme që varion nga 7.07 në 8.18. Numri i studentëve të rregjistruar në vite varion nga 7 studentë deri në 17 studentë. Gjithsejt numri i studentëve të rregjistruar në vitin e parë është 73. Numri i studentëve që janë diplomuar është 39 në total dhe brenda afatit normal të studimit 3 vite janë 23 studentë. Bazuar në Ligjin e Ri të Arsimit të Lartë, koha e zgjatjes së studimeve për studentët e tjerë është deri në dyfishin e kohës së studimit të programit. Janë punësuar 12 studentë kryesisht në kolegje. Ka një zyrë të marrëdhënive me studentë që informon ato për problemet e ndryshme, bën shpërndarjen dhe ndjekjen e praktikës profesionale, dhe jep informacione që

lidhen me punësimin e tyre dhe studimet e nivelit të dytë. Funkcionon Alumni që realizon aktivitete shumë interesante siç janë AWARDS për studentët që kanë mbaruar aty dhe që janë të suksesshëm në punë. Gjatë takimit me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit na u konfirmua se në këtë vit akademik, janë në vitin e parë 15 studentë, 11 studentë në vitin e dytë dhe 10 studentë në vitin e tretë.

Shiko Aneksë, Tabela 36-39

### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimit të studentëve

*Përveç zbatimit të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 KUB si edhe u theksua më lart ka edhe kritere specifike pranimi të studentëve, të cilat janë të mishëruara në rregulloren e studimit neni 5 ku përcaktohen si kriter nota mesatare e shkolles së mesme 70% dhe intervista 30%. Për programet që bëhen në gjuhë të huaj është edhe njohja e gjuhës së huaj Anglisht e nivelit B1. Ky program ofrohet në gjuhën angleze.*

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

*Në përgjithësi duhet pranuar se nota mesatare deri në vitin akademik 2017-18 ka qënë e konsiderueshme krahasuar edhe me institucionet e tjera homologe, dhe shkonte nga 7.07 në 8.18. Në vitin 2017-18 ishte 7.90. Përgjithësisht kjo mesatare ruhet edhe në dalje e studentëve, për ato studentë që kanë mbaruar*

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

*Studentë të regjistruar për herë të parë janë gjithsejt 73 me një notë mesatare 7.61 ndërsa studentë të diplomuar pa vite shtesë janë 23 me mesatare 3.31*

*Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse) janë 5. Nota Mesatare 3.26 (sipas sistemit amerikan të brëndeshëm të vlerësimit me notë nga 0 tek.4 që korespondon afërisht me notë mesatare 8.6)*

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

*Ka vetëm një student që ka shkuar në kuadrin e projektit Erasmus në universitetin e Helsinkit, Finland*

- Të dhëna për punësimin e studentëve

*Janë gjithsejt të punësuar 9 vetë si u deklarua gjatë vizitës, por ka edhe të punësuar jashtë profilit të diplomës, dhe duke marrë në konsideratë këto numri të punësuarve shkon në 30.*

- Numri total të diplomuarve

*Janë 36 të diplomuar.*

- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

*Janë vetëm 9 studentë*

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

*Janë 18 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën.*

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	<b>Rezulton se</b> pranimi i studentëve në vitet e para të hapjes të këtij program studimi është bërë bazuar në ligjin 9741 datë 21.05.2007, por pas vitit 2015 është bërë konform Ligjit 80/2015.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	<b>Rezulton se</b> Kolegji Universitar Beder ka vendosur edhe kritere specifike për pranimin e studentëve e cila konsiston në ndarjen 70% për notën mestare të shkollës së mesme dhe 30% për intervistën. Për programe në gjuhë të huaj, siç është edhe ky program studimi, edhe njohjen e gjuhës Angleze.

<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p><b>Rezulton se</b> institucioni ka një system informimi për student pasi funksionojnë një tërësi njësisish që merren me këtë aspekt, si Drejtoria e marrëdhënieve me studentët, Zyra e karrierës, këshilluesi akademik, si dhe zerë të veçantë në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><b>Konfirmojmë se</b> ka një vlerësim të pedagogëve nga ana e studentëve nepërmjet anketave on-line si pjesë e vlerësimit të performancës së pedagogut.</p> <p><b>Konfirmojmë se</b> Zyra e karrierës jep një informacion të detajuar studenteve si për punësimin ashtu edhe për aspekte të tjera që lidhen me karrierën e tyre.</p>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p><b>Rezulton se</b> institucioni ka statistika të plotë dhe për numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar apo edhe të përfundimit të studimeve, dhe bën një studim të detajuar të tregut për të parashikuar pritshmëritë.</p> <p><b>Rezulton se</b> institucioni ka të dhëna lidhur me ecurinë e studimeve të studentëve nepërmjet njësisive që ka ngritur dhe rregulloreve që disponon. Sekretaria mësimore, zyra e karrierës, këshilluesi akademik, zyra e marrëdhënieve me studentët, janë pjesë e realizimit të këtij procesi.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nepërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p><b>Konfirmojmë se</b> zyra e karrierës së bashku me këshilluesin akademik japin informacion të plotë studentëve për orientimin e tyre në procesin mësimor.</p> <p><b>Rezulton se</b> Zyra e karrierës luan një rol të rëndësishëm gjatë praktikave profesionale të studentëve me konsulencë dhe orientim të tyre.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Konkludojmë</b> se institucioni ka ngritur një strukturë funksionale e cila merret si me rregjistrimin ashtu edhe me orientimin e studentëve gjatë procesit mësimor.</li> <li><b>Konfirmojmë se</b> institucioni ka një informacion të plotë për ecurinë e studentëve gjatë procesit të studimit 3 vjeçar dhe ka ngritur një tërësi njësisish dhe disponon rregullore që e sigurojnë transparencën dhe qartësinë për planifikim të ecurisë të më vonëshme.</li> <li><b>Konfirmojmë se ka</b> një zyrë të karrierës e cila funksionon me cilësi dhe seriozitet dhe jo vetëm informon studentët, por edhe i ingranon ato në shoqata dhe aktivitete të larmishme</li> </ol>	

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor është pjesë e rëndësishme e misionit dhe objektivave në Institucion. Veprimtaria kërkimore-shkencore priret, organizohet e zhvillohet në zbatim të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë

në Republikën e Shqipërisë” duke u përqendruar kryesisht në realizimin e kërkimit shkencorë, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari krijuese sipas objektivave specifike të institucionit, programit në fjalë. Është i drejtpeshuar dhe efektiv raporti mes proceseve të mësimdhënies dhe kërkimit. Tentohet përfshirja e studentëve në procese kërkimore dhe projekte të departamentit. Kërkimi shkencor pasqyrohet edhe në faqen zyrtare të kolegjit. Institucioni boton në mënyrë periodike buletin shkencor BJES, organ rregjistruar me ISSN, i cili gjindet në trajtë fizike por dhe edhe në faqen zyrtare.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Ploteso Tabelat ne aneks)
- *Ka një plan strategjik nxitje për kërkimin shkencor, duke mbështetur edhe financiarisht pedagogët për kërkimin shkencor. Pedagogët gëzojnë të drejtën të marrin mbështetje financiare prej 700 euro për pjesmarrje në konferenca dhe botime.*
- *Ka organizuar për çdo vit konferencen shkencore ndërkombëtare ICES të Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe ICH e Shkencave humane si dhe ka në zbatim 6 projekte shkencore brenda institucionit.*
- *Ka një përfshirje të stafit në punën shkencore dhe kualifikimin shkencor nëpërmjet pjesmarrjes në aktivitete shkencore si konferenca, botime në revista shkencore ëorkshope dhe një përfshirje edhe e studentëve në këto veprimtari. Studentët e programit në fjalë janë të përfshirë në projektin për mbështetjen e fëmijëve të ngujuar.*
- *Ka një revistë shkencore BJES që botohet që botohet çdo vit që nga viti 2013*

### **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar Beder ka të përcaktuar prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit me institucione lokale kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me strategjinë afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të institucionit duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës. KUB ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe të arsimit të lartë, struktura shtetërore dhe private jashtë institucionit, apo edhe pedagogë të huaj që kanë lidhje me programet e studimeve.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)
- KUB ka marrëveshje bashkëpunimi me 40 universitete jashtë vendit dhe 6 universitete shqiptare. Po ashtu ka edhe marrëveshje bashkëpunimi me organizata dhe shoqata profesionale në shërbim të marvajtjes së punës në realizimin e programeve të studimit.
- Nga viti 2011 e deri 2018 ka organizuar rreth 26 konferenca nderkombetare me institucione si brenda ashtu edhe jasht vendit.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)
- Ka marrëveshje me organizata profesionale, me biznesin dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm për praktikat profesionale dhe për shërbime që ofron si trainime në fushën e mësimdhënies.
- Është i përfshirë në dy projekte si ai i Erasmus dhe Mevlana dhe ka patur mobilitete për studentë dhe pedagog.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p><b>Rezulton se</b> ka një bashkëpunim ndërdepartamental bazuar në angazhimin e ndërsjellët të pedagogëve duke siguruar përmbushjen e procesit mësimor në lëndë të ndryshme nga specialistë të mirëfilltë në fushat përkatëse dhe ka rritur mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave të pedagogëve.</p> <p><b>Rezulton se</b> ka një rregullore të organizimit administrative e cila mundëson ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive dhe krijon nje frymë bashkëpunimi.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p><b>Konfirmojmë se</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë dhe brënda vendit si dhe shoqata dhe është përfshirë në projekte shkencore me partner brënda dhe jashtë vendit.</p> <p><b>Konfirmojmë se</b> Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione si institucione të arsimit parashkollor dhe fillor sidomos për realizimin e praktikave me studentë gjatë verës (arsimi parashkollor) në rrethe apo struktura të tjera qendra dhe organizata profesionale cilat i mundësojnë studentët të realizojnë praktikën mësimore.</p> <p><b>Rezulton se</b> Departamenti është licensuar për të realizuar trainime në 4 module për mësimdhënien, të cilat i ka aplikuar në trainime që ka bërë me institucionet të tilla si kolegjet në nivelin parauniversitar.</p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Konstatojmë</b> se Kolegji Universitar Beder, ka një dokumentacion relativisht të pasur marrëveshjes bashkëpunimi me institucione homologe brënda dhe jashtë vendit në shërbim të rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të institucionit.</li> <li><b>2. Rezulton</b> gjithashtu se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me struktura shtetore dhe private si kolegjet parauniversitare e praktikave mësimore. Në planin e bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar dhe publik mund të thuhet që KUB ka bërë përpjekje dhe punë të kënaqshme në bashkëpunim.</li> <li><b>3. Mendojmë</b> se në të ardhmen duhet të rritet më shumë mobilitete e pedagogëve dhe studentëve në kuadrin e projekteve të Erasmus dhe Mevlana ku institucioni është pjesmarrës.</li> </ol>	

**ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

KUB ka plotësuar kryesisht rekomandimet e dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë.

**II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

## GVJ, konstaton:

- Nga vizitat në institucion dhe nga hulumtimi i materialeve të përfshira në RVB, rezultojnë që në vija të përgjithshme egziston përputhje të RVB me konstatimet që u bënë gjatë hulumtimit të raportit të brendshëm dhe gjatë vizitës së zhvilluar nga grupi i RVJ.
- Që programi BSc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” merr në konsideratë parimin bazë atë, të koherencës horizontale dhe vertikale mbi të cilin ndërtohet një program.
- Staf i akademik i brendshëm {PAE}, stafi administrativo-teknik, si dhe stafi {PAK}, përmbushin relativisht kriteret akademike. Staf i është i rekrutuar konform ligjit dhe rregullores së brendshme.
- Përmbushja e praktikave profesionale nuk është e institucionalizuar në të gjithë pikëpamjet: kontraktuale, procedurale dhe e udhëhequr didaktikisht, megjithëse në RVB thuhet se praktika është e rregulluar.
- Programi BSc në ‘Arsimin Parashkollor dhe Fillor’ zhvillohet në gjuhën angleze, përjashtim të lëndës së gjuhës shqipe dhe leterisë. Ky fakt mund të shikohet si avantazh por dhe në të kundërtën e vet.

### a. Pika të forta

1. Institucioni granton qëndrueshmëri për të përmbushur gjithë ciklin e programit Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor”. Me këtë fakt nënkuptojmë, {godina, financimet, mjediset akademike, kontratat e stafit të brendshëm dhe të jashtëm, teknologjia, logjistika, biblioteka}.
2. Studentët e përfshirë në programin Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” përbëjnë strukturë kryesisht “heterogjene”, kjo referuar faktit që studentët janë prurje nga arsimit i mesëm i përgjithshëm, kolegjet, dhe medresetë. Por, nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimi me studentët, konstatohet se përgjatë programit, studentët, “unifikohen” në qëllimin e shkollimit dhe bie në sy “kompaktësi” në aspektin e njohjes së objektivave akademike dhe procedurave metodologjike nga ana e tyre.
3. Prurjet e studentëve janë gjithëkombëtare, midis tyre përfiton studimet në programin në fjalë, një student nga Presheva.
4. Konstatohet qëndrueshmëria e personelit akademik {PAE}. Nuk ka ndërpreje të kontratave përgjatë programit.
5. Konstatohet që ka mjaftueshmërisht tituj literal, {manuale} të mirënjohura dhe të konfirmuara në funksion të programit.
6. Kontrollet e brendshme të cilësisë bëhet në mënyrë frekvente, i sofistikuar nga pikëpamja e strukturës së anketave dhe të pyetësorëve, i dokumentuar, i aksesueshem nga të interesuarit, dhe përmbushet referuar parimeve të konfidencialitetit dhe të etikës në përgjithësi.
7. Kolegji Universitar Beder, parashikon mundësi financiare për çdo pedagog të përfshirë në program, deri në 700 euro në një vit akademik, në funksion të përmbushjes së zhvillimit individual profesional. Institucioni ndjek ecurinë e studentëve edhe pas përfundimit të studimeve dhe promovon cilësitë dhe arritjet e tyre. Institucioni ka inicuar dhe zyrën Alumni dhe jep cmime në aspekte të ndryshme të dijes, gjë që rrit reputacionin e institucionit në rrafshin akademik dhe social, përtej institucionit.

### b. Pika dobëta:

1. Programi Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” vjen i tej ngarkuar për faktin që: synon të prodhojë dy profile mësuesish, për parashkollor dhe për ciklin fillor. Referuar faktit të mësipërm, Diploma nuk mundet të jete e unifikuar, ndërkohë që synohen dy profile mësuesish, të ngjashëm për nga misioni por të ndryshëm për nga specifika e grup-moshave me të cilat pritet të punojnë.
2. Bën në sy që, programi i mungojnë dimensionet kurrikulare substanciale si: shtrati ligjor mbi të cilin funksionon arsimit parashkollor dhe fillor në Republikën e Shqipërisë. Sjellim ndërmend dokumentin kaq të nevojshëm si “Standardet e Arsimit Parashkollor”, dokument mbi të cilin lipset të ngrihet ky cikël edukimi, produkt i IZA
3. Syllabuset që derivojnë dhe përmbushin programin në fjalë, rezultojnë anemike në një këndvështrim, atë të raportit të brendshëm që detyrimisht duhet të ketë programi: raporti dije teorike me dijen aplikative.shprehur edhe përgjatë RVJ.
4. Konstatojmë se mungojnë politikat e institucionit për përfshirje të studentëve me aftësi të kufizuara, ndërkohë që konstatuam politikat të mirëfillta për studentë në nevoja specifike ekonomike dhe që paraqesin profile të spikatura në raport me interesat për shkollim. Kjo referuar dhe faktit që

institucioni ushqehet nga Fondacioni afiz Ali Korca, dhe filozofia e qëllimet për të cilat ky fondacion është ngritur dhe funksionon.

**c. Mundësitë:**

1. Besimi se Programi BSc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” gjen hapësirë në listën e profesioneve të rregulluara në edukim dhe arsimim. Nga panorama holistike që siguroam përgjatë vizitës por dhe nga projektionet personale të krijuara para, gjatë dhe pas vizitës, krijuam besimin se studentët e përfshirë në program, kanë hapësira punësimi në institucionet me të cilat ndajnë qëllime dhe filozofi të përbashkët edukimi.
2. KUB, funksionon si institucion i mirëfillte në respekt të ligjit dhe të rregulloreve të brendëshme, por, dukshëm përmbushet mbi parime të besimit, çka e shton, besimin se më shumë studentë potencialë mund të rregjistrohen në programet e edukimit në këtë institucion.
3. KUB dhe specifikisht programi BSc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” potencon studentët në mbështetje financiare për arsyet e përmendura më lart, gjë që e ben atraktiv regjistrimin në programe të mirëfillta edukimi.

**d. Pengesat:**

1. Programi BSc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor” është i konkurueshëm në tregun e dijes në fushat e mësuesisë. Shumë IAL në Republikën e Shqipërisë ofrojnë programe mësuesie në ciklin parashkollor dhe fillor.
2. Diploma që ofron programi në fjalë, i përfshin studentët {të diplomuarit} në proceset e profesioneve të rregulluara, gjë që kërkon detyrimisht të përmbushen minimalisht dhe dy nga pesë sygjerimet e lëna në akreditimin e vitit 2013.

## **SUMMARY ANALYSIS OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION**

### **I. COMPREHENSIVE ANALYSIS OF THE FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION**

KUB has mainly completed the recommendations given from AC in the first accreditation decision.

### **II. COMPREHENSIVE ANALYSIS OF EER ACCORDING TO THE SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)**

**EEG, concludes:**

- From visits in the Institution as well as the reviewing materials included in the internal evaluation report (IVR), it results that in general there is a consistency of IVR with the findings made during the internal report research and during the visit of the EEG report
- The BSc study program in Pre-school education and Primary Education; takes into account the basic principle of horizontal and vertical coherence on which a program is built.
- Internal academic staff (IAS), administrative-technical staff, and external academic staff (ECS), relatively meet the academic criteria. The staff is recruited according to the law and internal regulation.
- The fulfillment of professional practices is not institutionalized in all aspects: contractual, procedural and didactically instructed, although at internal evaluation report (IER) it is said that the practice is regulated.
- The BSc study program in Pre-school education and Primary Education; the lesson is done in English, except the subject of Albanian language and literature. This fact can be seen as an advantage but also as a disadvantage.

### **a. Strong points**

1. The institution grants consistency to fulfill the entire cycle of the Bsc study program Pre-school and Primary Education;. By this fact we mean - buildings, financing, academic environments, contracts of internal and external staff, technology, logistics, libraries.
2. Students involved in the BSc program "Preschool and Primary Education" structure comprise mostly "mixed", it referred to the fact that students are feeds from general secondary education, colleges and madrasas. But the site visit and conversation with students, concluded that during the program, the students, "unify" the purpose of education and showy "compactness" in terms of recognition of academic and methodological procedures objectives by them.
3. Students who are attending their studies here are nationwide; among them there is also a student from Presevo who is benefiting from this study program;
4. We found out the sustainability of the academic staff. There is no interruption of the working contracts throughout the program;
5. It is found that there are enough literal, (manual) titles that are well-known and confirmed in function of the program.
6. Internal quality control is done in a frequency-way, sophisticated manner with regard to the structure of surveys and questionnaires, documented, accessible to the interested, and is met with reference to the principles of confidentiality and ethics in general.
7. University College Beder provides financial opportunities for every teacher involved in the program, up to 700 Euros per academic year, in function to the individual professional qualification.
8. The institution follows the progress of students even after completing the studies and promotes their qualities and achievements. The institution has also initiated the Alumni office and gives awards in various aspects of knowledge, which enhances the reputation of the institution in the academic and social sphere beyond the institution.

### **b. Weak points:**

1. The Bsc study program in Pre-school Education and Primary Education; is overloaded by the fact that: it intends to produce two profiles for teachers: preschools teachers and primary cycle teachers. Referring to the above fact, the diploma can not be unified, while aiming for two teacher profiles, which are similar to mission but different from the specifics of the group ages that are expected to work with.
2. It can be noticed that there lack substantial curricular dimensions of the study program such as the legal framework on which the preschool and primary education functions in the Republic of Albania. We mention the necessary document on Preschool Education Standards; the document on which this education cycle should be based, a product from the Institute of Education Development. (IED)
3. The syllabuses that derive and fulfill this program result anemically from a perspective, that of the internal report that the program must necessarily have: the theoretical knowledge report with the applicable knowledge also expressed throughout the EER.
4. We noted that the Institution policy on inclusion of students with disabilities is lacking, meanwhile we noticed genuine policies for students in specific economic needs that represent prominent profiles in relation to education interests. This is referred to the fact that the institution is supported by Hafiz Ali Korca Foundation, and the philosophy and goals for which this foundation has been established and functioning.

### **c. Opportunities :**

1. The belief that the BSc study program in Pre-school and Primary Education; finds space in the list of regulated professions in education and teaching. From the holistic panorama we provided during the visit but also from personal projections created before, during and after the visit, we created the belief that the students

involved in the program have employment opportunities in institutions that share the same educational goals and philosophy.

2. UCB functions as an authentic institution in respect of the law and internal regulations, but it is obviously fulfilled on the principles of trust, which adds to the belief that more potential students can be enrolled in education study programs in this institution.

3. The UCB, and specifically the BSc study program Pre-school and Primary Education; emphasizes students in financial support for the reasons mentioned above, which makes it an attractive study program for students who want to be enrolled in authentic education programs.

**d. Threats:**


1. The BSc study program in Pre-school and Primary Education is competitive in framework of the knowledge market in the fields of teaching. Many HEI-s in the Republic of Albania offer teaching programs on the preschool and primary cycle.

2. The diploma offered by this study program includes graduate students in regulated occupation processes, which necessarily requires minimum fulfillment of two out of five suggestions given on the 2013 accreditation process.

**External Evaluation Group**

**1. Prof. Dr. Gëzim Dibra**

**2. Prof. As. Dr. Mariana Sinani**



**Përgjigja e GVJ në lidhje me komentet e bëra nga Kolegji Universitar "Bedër" mbi Draft RVJ e programit në process të vlerësimit periodic, Bsc në "Arsim parashkollor dhe fillor"**

1. Rekomandimi 1, faqe 4 - Për rekomandimin e parë - Institucioni ka bërë përpjekje për të përmirësuar formulimin e diplomës dhe suplementit. **Nuk mendojmë se i ka dhënë zgjidhje përfundimtare këtij problemi.** Ka ndryshime në emërtim në vendimet e MASR- së në kohën e licensimit dhe të akreditimit të këtij programi.

- *Përgjigja nga KUB - Përsa i përket këtij rekomandimi institucioni dhe grupi i punës është përpjekur të jetë konsistent në përdorimin e termit Bachelor në Arsimin Parashkollor dhe Fillor, në përputhje kjo edhe me vendimin e licensimit. Konfirmohet ashtu siç është përmendur edhe nga ekspertët në GVJ që ka ndryshime në emërtim në vendimet e MASR-së në kohën e licensimit dhe akreditimit. Referuar shkresës me numër 73/24 datë 08/04/2013 nga APAAL në draft raportin e jashtëm emërtimi i programit të studimit është Bsc në Arsimin Parashkollor dhe Fillor ashtu si në shtojcën bashkëngjitur.*

- **Përgjigja e GVJ** – Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. Siç edhe e kemi theksuar dhe ritheksuar edhe në Raport, emërtimi I këtij programi studimi, panvarësisht ndryshimeve të shumta në Vendimet e MASR në vite, që nga koha e licensimit të tij, akreditimit të parë, rregjistrimit në format e diplomës, është ashtu si edhe në Modelin e Diplomës dhe Suplementit të saj të dhënë nga KUB gjatë vizitës në Institucion, I cili përkon me të gjithë dokumentacionin shkresor të ngarkuar në sistemin AMS, por edhe me Urdhërin Nr 420, datë 20.09.2017 të MASR "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr 61, datë 09.02.2016 "Për rregjistrimin e formave të diplomave "bachelor"; "Master profesional" dhe "Master I Shkencave" të shkollës së Lartë Private "Hëna e Plotë", (Bedër), Tiranë". Emërtimi I diplomës është Bsc në "Arsim parashkollor dhe fillor"

2. Rekomandimi 2, faqe 4. Për rekomandimin e dytë - Institucioni **ka përmisuar objektivat e programit nga të përgjithshmet e specifike, të transferueshme.** Por, nuk ka përkthyer objektivat në kopetencia profesionale. Institucioni ka dorëzuar pranë MASR programet e reja të studimit të ndara në: BSc "Arsim parashkollor dhe Fillor", si dhe program Master profesional në "Arsim Fillor" por ende nuk është zbatuar një ndarje e tillë.

*Përgjigja nga KUB - Përsa i përket komentit shtesë të kësaj pike të rekomandimit, ashtu sikundër është konstatuar edhe nga vetë ekspertët, IAL ka depozituar në MASR kërkesën për riorganizim programi studimi dhe kërkesën për hapje programi të ri studimi përkatësisht me shkresë 1. Nr 99/1, datë 29.10.2017 "Kërkesë për riorganizimin e 6 (gjashtë) programeve", shkresë në të cilën kërkohet riorganizimi i programit Bsc në arsim fillor. 2. Me shkresë nr 19, datë 09.02.2018 "Kërkesë për hapje programesh të reja", është kërkuar hapja e programit Bachelor në Mësuesi Arsim parashkollor dhe 3. Me shkresë nr 29, datë 28.01.2019 "Hapja e programeve të reja". Zbatimi i ndarjes së profileve në përputhje edhe me parashikimet e Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 do të bëhet pas marrjes së miratimit nga organet përkatëse të MASR, vendimmarrje e cila kalon përtej kompetencave dhe vullnetit institucional.*

**Përgjigja nga GVJ** – Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. Ekspertët kanë besim se KUB do të veprojë sipas legjislacionit në fuqi pas marrjes së miratimit nga MASR.

3. Rekomandimi 3, faqe 4. Për rekomandimin e tretë - Institucioni **ka shtuar numrin e orëve të praktikës profesionale duke e fuqizuar atë përmes formave të intershipit në institucione gjatë periudhës së verës. Kurse raportet dije teorike - dije aplikative në lëndë specifike nuk gjenden ende të formuluar në syllabuset.** Përgjigja e KUB - Përsa i përket plotësimit të këtij rekomandimi ashtu siç i është pohuar edhe ekspertëve formati i zhvillimit të orëve të mësimi në klasë është një integrim midis leksioneve dhe seminareve. Kjo nuk konfigurohet drejtëpërdrejtë në syllabuse por gjen pasqyrim në to me anë të ndërthurjes së punës me projekte, quize, detyra kursi etj. Theksojmë se në programet e riorganizuar dhe programet e reja është bërë ndarja teori/praktikë.

**Përgjigja e GVJ** - Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. Ekspertet janë shprehur për atë çka kanë gjetur dhe shikuar në syllabuse. AQ mqë shumnë që vetë KUB pranon se kjo ndarje është bërë në programet që do të riorganizohen.

4. Rekomandimi 4, faqe 4. Për rekomandimin e katërt - **Institucioni ende arsyeton se mësimdhënja dhe metodat specifike që lidhen me lëndë specifike, është konceptuar si një gërshetim i leksionit me ushtrime,**

*laboratore, veprimtari praktike e punë në grupe sidomos në lëndët si edukim figurative apo muzikor, [mungojnë atelie] enkas në përmbushje të programit specifik*  
Përgjigja e KUB - Përsa i përket plotësimin të këtij rekomandimi për gërshtëtimin e leksioneve me ushtrime, laboratore, veprimtari praktike e punë në grupe, janë vënë në dispozicion të lektorëve dhe të studentëve laboratorit i informatikës dhe gjuhëve të huaja, palestra e institucionit, qendra e medias dhe salla e konferencave. Për zhvillimin e lëndëve të tilla si Arti muzika dhe loja përdoret një sallë e posaçme në katin e gjashtë.

**Përgjigja e GVJ** - Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. GVJ është shprehur se mungojnë atelie. Do ishte mirë që salla e posaçme të kthehet në atelie në të ardhmen për zhvillimin e lëndëve specifike.

5. Rekomandimi 5, faqe 4. Për rekomandimin e fundit - Në evidencat e paraqitura rezulton se në vitin akademik 2015-2016 Departamenti i Shkencave të Edukimit ka patur staf PAE 8 vetë nga të cilët 6 me tituj dhe grada shkencore dhe staf PAK 11 vetë nga të cilët 3 me grada shkencore, në total 19 vetë nga të cilët 9 me tituj dhe grada shkencore. Në vitin akademik 2018-2019, stafi PAE është 8 vetë nga të cilët 3 me gradë shkencore, dhe stafi PAK 3 vetë nga të cilët 2 me gradë shkencore, në total 11 vetë nga të cilët 5 me titull Dr dhe një doktorant. **Konstatohet se nuk ka një rritje në stafin me tituj apo grada shkencore.**

Përgjigja e KUB - Në lidhje me rekomandimin e pestë i cili kërkon rritjen e numrit të stafit të kualifikuar me gradën Dr, konfirmohet që ka një rritje të stafit akademik me tituj krahasuar kjo me vitin 2013, kohë kur programi ka marrë akreditimin e parë dhe kohë në të cilën është dhënë ky rekomandim. Në vitin 2013 kohë kur programi iu nënshtrua akreditimit të parë dhe kohë në të cilën u artikuloan rekomandimet përkatëse, numri i stafit me grada Dr. në departament ashtu si edhe është pasqyruar në raportin e vlerësimit të brendshëm të vitit 2013 ishte tre. Në vitet pasardhës numri i stafit me grada Dr. pavarësisht ndryshimeve nga njëri vit në tjetrin ka qenë përherë më i lartë se tre sikurse konstatohet edhe në raportin e GVB për programin.

**Përgjigja e GVJ** - Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. Në këtë vit akademik, e ritheksojmë se stafi PAE është 8 vetë nga të cilët 3 me gradë shkencore, dhe stafi PAK 3 vetë nga të cilët 2 me gradë shkencore, në total 11 vetë nga të cilët 5 me titull Dr dhe një doktorant.

6. Standardi 2.1, kriteri 2, faqe 6. Për riorganizimin e programit të studimit, I cili është lënë edhe si rekomandim në akreditimin e parë, KUB I është drejtuar MASR me shkresa zyrtare për këtë riorganizim

Përgjigja e KUB - Saktësojme se riorganizimi i programeve nuk është lënë si rekomandim nga akreditimi i parë, megjithatë në zbatim të Ligjit për Arsimin e lartë 80/2015 institucioni ka aplikuar për ndarjen e programit. Kjo ndarje kryhet përmes një riorganizimi programi dhe një hapje programi të ri, hapje kjo e cila duhet konsideruar si një riorganizim më rrënjësor.

**Përgjigja e GVJ** – GVJ e merr në konsideratë këtë koment dhe bën ndryshimin përkatës në RVJ.

7. Konkluzione pika 2 faqe 11 Nga vizita në institucion **nuk na rezulton** që të ketë mjedise laboratorike/atelje në funksion të programit Bsc në “Arsim Parashkollor dhe Fillor”, enkas në funksion të përmbushjes së programit, detyrim që institucionit i është lënë nga procesi i akreditimit të kaluar. Pedagogët deklarojnë se brenda ambienteve ku bëjnë mësim realizojnë edhe punimet laboratorike sidomos në lëndën e edukimit artistik.

Përgjigja e KUB - Për gërshtëtimin e leksioneve me ushtrime, laboratore, veprimtari praktike e punë në grupe, janë vënë në dispozicion të lektorëve dhe të studentëve laboratorit i informatikës dhe gjuhëve të huaja, palestra e institucionit, qendra e medias dhe salla e konferencave. Për zhvillimin e lëndëve të tilla si Arti muzika dhe loja përdoret një sallë e posaçme në katin e gjashtë.

**Përgjigja e GVJ** – Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. GVJ mban të njëjtin qëndrim si në rekomandimin e mësipërm ku flitet sërisht për këtë çështje.

8. Standardi III.3 faqe 11 - **Konfirmojmë** nga vizita dhe bashkëbisedimi me zyrën e këshillimit të studentëve se kishte angazhim serioz të stafit për të orientuar studentët drejt praktikave profesionale, por nuk konstatuam që kjo të ishte e rregulluar me marrëveshje specifike ndërinstucionale.

*Përgjigja e KUB - Konfirmojmë që ekzistojnë marrëveshje ndërinstucionale të cilat rregullojnë zhvillimin e praktikave profesionale. Një shembull marrëveshjeje është ngarkuar në sistem pas kërkesës së GVJ dhe mund ta rigjeni bashkëngjitur. Ekzistenca e marrëveshjeve të bashkëpunimit të konsideruara si marrëveshje mirëkuptimi është pranuar edhe nga vetë grupi i ekspertëve në GVJ Standardi 5.2 faqe 13.*

**Përgjigja e GVJ** – Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. GVJ i qëndron mendimit se Institucioni ka marrëveshje mirëkuptimi por duhet që këto marrëveshje të jenë të rregulluara dhe institucionale në gjithëkuptimësinë e tyre..

9. Konkluzione standardi VI.1. faqe 15. **Rezulton se** institucioni ka burime financiare për të bërë të mundur realizimin e programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, por, **duhet të pranojmë se në tre vitet e fundit të ardhurat e institucionit janë në ulje.**

*Përgjigja e KUB - Konfirmohet që Kolegji Universitar Bedër është institucion jofitimprurës dhe si i tillë të ardhurat ndryshojnë vit pas viti në varësi të numrit të studentëve dhe bursave të aplikuara.*

**Përgjigja e GVJ** – Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. Është fakt që shpresojmë të rregullohet në të ardhmen me rritjen e numrit të studentëve.

10. Konkluzione Standardi VIII.1 faqe 17. mendojmë **se disa mangësi të konstatuara në programin mësimor** si dhe në mos përmirësimin e tij bazuar në udhëzimet e MASR-së, në ngarkesat e pedagogëve me lëndë jashtë profilit, **trejtojmë se duhet bërë më shumë konkretisht.**

*Përgjigja e KUB - Përsa i përket ngarkesës së pedagogëve në lëndë specifike të konsideruara jashtë profilit institucioni ka bërë shpalljen e vendeve vakante për lektorë të jashtëm dhe pas aplikimeve të marra, janë rekruar lektorët përkatës profesionistë të fushës. Bashkëngjitur vendimi i departamentit për kërkesë për staf dhe miratimi nga ana e komisionit. Bashkëngjitur do të gjeni cv-në e Dr. Majlinda Hala e cila do ta japë këtë lëndë në semestrin e pranverës dhe në vazhdim.*

**Përgjigja e GVJ** – Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. GVJ vlerëson masat e marra nga KUB pas vizitës së GVJ në këtë Institucion.

11. Konkluzione Standardi II.4. faqe 20. **Rezulton se në disa aspekte** plani mësimor ka nevojë për përmirësime për tu përshtatur me Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2017, dhe udhëzimin e fundit nr 41 datë 24.01.2018 të MASR-së. **Duhet të punohet për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga akreditimi i vitit 2013, si dhe mangësive të tjera të konstatuara të përmëndura më lart tek vlerësimi i treguesve të matshëm.**

*Përgjigja e KUB - Përsa i përket përditësimit të programit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi të tilla si Udhëzimi nr.31, datë 29.12.2017, theksohet se përditësime të programit të cilat parashikojnë ndryshime kurrikulare janë ndërmarrë në kuadër të riorganizimit të programit dhe pritet vendimmarrja nga autoritetet përkatëse.*

**Përgjigja e GVJ** – Nuk bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar. GVJ ka bërë vlerësimin mbi programin aktual dhe jo atë që pritet të riorganizohet,

12. Konkluzione Vlerësimi Standardi VII.2. faqe 25 **Në përfundim të vlerësimit, GVJ konstaton se:** Institucioni, në funksion të programit të studimit, nuk disponon CD profesionale {me theks didaktik} të pajisura me {"situatë rasti"} Kjo do të rriste cilësinë e përmbushjes së programit në fjalë, dhe veçanarisht do të orientonte studentët drejt metodologjive dhe instrumentave teknike se si operohet në kontekste specifike mësimdhënie në ciklin parashkollor dhe fillor.



*Përgjigja e KUB - Meqënëse mësimdhënia në institucion është bazuar në mësimdhënien interaktive me përdorimin e tabelës smartboard dhe akses në librari online të tilla si ebscohost studentëve u mundësohet shfaqja në kohë reale në sallë e sekuencave me përmbajtje didaktike të marra nga internet apo nga vetë softëare metodologjike dhe didaktike që përdoren nga lektorët. Aksesit në çdo kohë i studentëve dhe lektorëve në internet, softëare të ndryshme dhe paketa didaktike metodologjike dhe seanca mikromësimi të stimuluar online nuk ka paraqitur nevojën për posedim të CD-ve të tilla.*

**Përgjigja e GVJ** –Bëhet ndryshimi në Raportin përfundimtar duke hequr këtë paragraf si sugjerim për KUB.

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**  
**Prof.Dr.Gëzim Dibra**  
**Prof.As.Dr.Mariana Sinani**

